QENDRA KOMBËTARE BURIMORE PËR SHOQËRINË CIVILE NË SHQIPËRI

# Gazetë Tremujore

**Edicioni Nr. 14 Tetor 2022**

*Kjo gazetë, është një publikim tremujor që pasqyron aktivitetet e Qendrës Kombëtare Burimore dhe zhvillimet më të fundit në sektorin e shoqërisë civile në Shqipëri, mundësitë për financim, rritje kapacitetesh e rrjetëzim për OShC-të si dhe informacione të tjera relevante nga rajoni e më gjerë.*

## NË KËTË EDICION


**AKTIVITETET E NRC-SË**

- *Anëtarësisë së Kodit të Standardeve për OJF-të në Shqipëri i bashkohen anëtarë të rinj!*
- *Shërbimi ligjor për organizatat e shoqërisë civile*
- *Aktivitete nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri*
- *Akademia e OJF-ve*
- *Asistencë dhe mentorim për pjesëmarrësit e Akademisë*
- *Programe Trajnimi për OSHC-të*

**ZHVILLIMET E FUNDIT NË SEKTOR**

- *Forum Rajonale mbi Ndikimin e Covid-19 në Ballkanin Perëndimor*
- *Barometri Kombëtar i të Drejtave të Njeriut, gjatë periudhës së Pandemisë Covid-19*
- *Tirana Connectivity Forum*
- *Të qënit i përgjeshëm- Rrugët tona të ndryshme drejt gjithëpërfshirjes, diversitetit dhe kalimit të pushtetit*
- *Konferenca "Politika Rinore në Ballkanin Perëndimor"*

**THIRRJE DHE MUNDËSI**

- *Thirrje*
- *Njoftime*

*Shërbimi ligjor për organizatat e shoqërisë civile, grupimet informale të aktivistëve*

*Nëse keni pyetje apo nevojë për informacion rreth çështjeve ligjore që ndikojnë aktivitetin e organizatës suaj, na kontaktoni në info@resourcecentre.al për të rezervuar seancën tuaj të këshillimit me Eksperten Ligjore*

## *Anëtarësisë së Kodit të Standardeve për OJF-të në Shqipëri i bashkohen anëtarë të rinj!*

*Anëtarësia e Kodit vazhdon të zgjerohet me anëtarë të rinj! Muajtë e fundit, Qendra psiko - sociale "Vatra", COSV në Shqipëri, Forumi i Gruas Elbasan, Shoqata Kombëtare Edukim për Jetën - (SHKEJ) dhe Fondacionit "Fryma e Dashurisë" – Diakonia Agapes, kanë shprehur vullnetin e tyre për t'u anëtarësuar në Kodin e Standardeve për OJF-të dhe për të zhvilluar veprimtarinë e tyre sipas parimeve dhe angazhimeve të Kodit.*

*Kodi i Standardeve për OJF-të në Shqipëri është një mekanizëm vetërregullues i cili synon të rrisë efektivitetin e punës së tyre si dhe besimin tek mbështetësit, përfituesit dhe grupe të tjera të interesit, nëpërmjet zbatimit të praktikave të mirëqeverisjes së sektorit si dhe rritjes së transparencës dhe llogaridhënies. Kodi është një tërësi parimesh dhe angazhimesh mbi mënyrën se si organizatat zhvillojnë veprimtarinë e tyre.*

*Ai është një mjet për të ndërtuar organizata më të forta dhe më efektive në sektorin jofitimprurës duke krijuar një bazë mbi të cilën praktikat e drejtimit dhe manaxhimit vlerësohen dhe përmirësohen. Kodi i udhëheq OJF-të në një proces edukimi dhe ndryshimi, drejt standardeve më të larta, duke zhvilluar kështu besimin tek palët e interesuara dhe duke rritur legjitimitetin dhe besueshmërinë e OJF-ve.*

*Anëtarësia e Kodit të Standardeve përbëhet nga 21 organizata jofitimprurëse. Procesi i anëtarësimit është i hapur në çdo kohë!*

*Ftojmë të gjitha organizatat e interesuara të dërgojnë shprehjen e interesit dhe dokumentacionin e nevojshëm në platformën standards4npo.al !*

*Për më shumë informacion mbi procesin e Anëtarësimit lexoni këtu ose na shkruani në info@resourcecentre.al*


Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian

PARTNERËT SHQIPËRI PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

*Qendra Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QKB), është një iniciativë e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim, zbatuar në partneritet me Qendrën Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin (ACPD) dhe Lëvizjen Europiane në Shqipëri (EMA). Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk reflekton domosdoshmërisht pikëpamjet dhë qëndrimet e Bashkimit Evropian.*

## *Help desk*

## *Shërbimi ligjor për organizatat e shoqërisë civile*

*Qendra Kombëtare Burimore vijon ofrimin e shërbimit ligjor për OJF-të dhe aktivistët e shoqërisë civile.*

*Ofrimi i shërbimeve me pagesë në përputhje me kuadrin ligjor dhe përjashtimi I tyre nga TVSH-ja, procedurat për ngritjen e ndërmarrjeve sociale, zgjedhja dhe rifresikimi i organeve vendimmarrëse në përputhje me legjislacionin e ri për regjistrimin e OJFve, si dhe aspekte të tjera të proceseve vendimmarrëse brenda organizatës, kanë qenë fokusi i konsulencës ligjore në këta muaj.*

*Gjithashtu një sërë organizatash të sapo themeluara janë asistuar mbi hapat dhe procedurat ligjore të regjistrimit pranë organeve kompetente sipas legjislacionit për OJF-të. Për më shumë informacion mbi shërbimin ligjor dhe si të përfitoni prej tij, lexoni këtu.*



## *Aktivitete nga zyrat rajonale të Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri*

*Takim me rrjetin e OJF të Vlorës për mbrojtjen e Pyllit të Sodës, për koordinim dhe organizimin e një fushatë ndërgjegjësimi për pastrimin e pyllit me moton: "Merrni në shtëpi ato që sillni me vete"- **Zyra Rajonale Vlorë***



*Shërbime help desk për OJF lokale mbi mundësi financimi dhe thirrje për projekt propozime të donatorëve të ndryshëm, mbështetje për nismat advokuese për mbrojtjen e gjirit të Vlorës nga industria e naftës, dhe mbështetje për OJF për plotësimin e kërkesave të Kodit të Standardeve - **Zyra Rajonale Vlorë***

*Sesione informimi me të rinj të shkollave të mesme të qytetit, të rinj aktivistë të organizatës me Komunitetin për Ndryshim si dhe një grup mësuesesh të shkollave të qytetit të Vlorës, për rritjen e angazhimit qytetar dhe përfshirjen e të rinjve në vendimarrjen vendore.- **Zyra Rajonale Vlorë***

*Sesione të hapura me të rinjtë e Universitetit të Shkodrës për nxitjen e vullnetarizmit dhe mundësitë që ofron programi Erasmus Plus për të rinjtë në Universitete– **Zyra Rajonale Shkodër***

*Takime me gazetarët e mediave lokale mbi bashkëpunimin dhe ndërtimin e partneriteteve midis OJF-ve dhe Medias - **Zyra Rajonale Shkodër***



*Pjesëmarrje në takime me institucione dhe aktorë të tjerë lokalë, lidhur me zhvillimin ekonomik në Bashkinë Shkodër, me fokus të veçantë tek turizmi.- **Zyra Rajonale Shkodër***

## *Fuqizim kapacitetesh*

## *Akademia e OJF-ve*

*Programi i Akademisë së OJF-ve 2022 ka vijuar gjatë këtyre muajve me leksionet mbi Shkrimi i projekt-propozimeve dhe manaxhimi i projekteve të BE-së; Ngritja e fondeve. Sigurimi i mbështetjes nga grantet, fondet publike, filantropia dhe puna me sektorin privat; dhe Krijimi dhe funksionimi i rrjeteve dhe koalicioneve.*

*Shkrimi i projekt-propozimeve dhe manaxhimi i projekteve të BE-së*

*#Leksioni6 u fokusua mbi formatin e aplikimit për financim të BE-së, ciklin e menaxhimit të projektit duke analizuar sfidat dhe dhënë rekomandime për tejkalimin e këtyre vështirësive.*

*Leksioni u drejtua nga Ledina Gjiknuri eksperte në shoqërinë civile me eksperiencë më shumë se 17 vjeçare në fushën e mobilizimit të fondeve të BE-së, në nivel planifikimi të asistencës së BE-së për fondet IPA, programimi dhe hartimi të dokumenteve analitike si dhe mbështetjeje në përgatitjen/vlerësimin e aplikimeve për grante në kuadër të financimit të BE-së/Instrumentit për Para-anëtarësimin (IPA).*

*Ngritja e fondeve. Sigurimi i mbështetjes nga grantet, fondet publike, filantropia dhe puna me sektorin privat;*

*#Leksioni7 u fokusua mbi rëndësinë e ngritjes së fondeve si mjet për rritjen e qëndrueshmërisë financiare të OJF-ve, mundësitë, tendencat e zhvillimit dhe metodat e ngritjes së fondeve nga aktorë të ndryshëm.*

*Leksioni u drejtua nga Entela Pinguli, eksperte në shoqërinë civile me eksperiencë 25 vjeçare, kryesisht në nisma të fokusuara në mbrojtjen e mjedisit dhe mbështetjen për rritjen e kapaciteteve të aktoreve të shoqërisë civile, si OSHC, bashki dhe biznese në funksion të përmirësimit të kontributit të tyre në shoqëri.*

*I ftuar si folës në këtë leksion ishte edhe Kleti Kaprata, Zv.Drejtor, Departamenti Marketingut në Credins Bank, për të prezantuar platformën e parë Crowdfunding në Shqipëri smile.al dhe thirrjen e dytë për projekte në këtë kuadër. Platforma smile.al ka për qëllim mbledhjen e fondeve nga publiku për realizimin e projekteve me karakter social.*




*Krijimi dhe funksionimi i rrjeteve dhe koalicioneve.*

*#Leksioni8 u fokusua mbi konceptet e rrjetit dhe të koalicionit, modele të ngritjes së tyre, avantazhet dhe sfidat si dhe shembuj të suksesshëm rrjetëzimi në rajon. Ndarja e eksperiencave të pjesëmarrësve dhe të mësimet e nxëna përgjatë rrugës së bashkëpunimit dhe partneritetit në rrjete dhe koalicione ishin gjithashtu pjesë e këtij leksioni.*

*Leksioni u drejtua nga Tanja Hafner Ademi eksperte me një përvojë të konsiderueshme profesionale ndërkombëtar veçanërisht në zhvillimin e shoqërisë civile, bashkëpunimit rajonal, integrimit në BE dhe menaxhimit të projekteve. Znj. Ademi ka qënë pjesë e ekipit që ka kryen Vlerësimin Afatmesëm të Instrumentit të Shoqërisë Civile IPA 2011-2016 për nevojat e DG NEAR. Gjithashtu si Drejtuese e ekipit, ajo ka menaxhuar TACSO 3, projektin kryesor rajonal të shoqërisë civile të BE-së në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi përgjatë 2019-2021. Znj. Ademi ka ofruar ekspertizë kyçe për zhvillimin dhe përditësimin e Udhëzimeve të BE-së për Mbështetjen e Shoqërisë Civile në Vendet e Zgjerimit.*




## *Asistencë dhe mentorim për pjesëmarrësit e Akademisë*

*Krahas leksioneve, si pjesë e Akademisë janë zhvilluar edhe sesione mentorimi dhe asistence në grupe dhe individualisht sipas nevojave të pjesëmarrësve në Akademi, duke i udhëzuar dhe asistuar në shkrimin e projekt propozimeve, ngritjen e fondeve dhe krijimin dhe funksionimin e rrjeteve etj, duke kontribuar në këtë mënyrë drejtpërsëdrejti në rritjen e standardeve të punës dhe qendrueshmërisë së organizatave të tyre.*

## Fuqizim kapacitetesh

### Programe Trajnimi për OSHC-të

### 1 Gjenerimi i të ardhurave për OSHC-të nga shërbimet me pagesë, produktet dhe asetet

*Programi i trajnimit dhe mentorimit mbi "Gjenerimi i të ardhurave për OSHC-të nga shërbimet me pagesë, produktet dhe asetet" ka vijuar me zhvillimin e të tjera moduleve. Si pjesë e moduli të tretë "Ndërtimi i Modelit të Biznesit" u punua mbi çështje si njohja e konceptit të modelit të biznesit, elementët përbërës si dhe hapat për ndërtimin e tij. Rëndësi të veçantë j`u kushtua modelit të biznesit Canvas për t`u aplikuar në zhvillimin e produkteve/shërbimeve me pagesë që organizatat pjesëmarrëse në program, synojnë të ofrojnë.*

*Moduli i katërt u fokusua mbi "Krijimi i një Strategjie të Qëndrueshme Marketingu", përmes së cilit pjesëmarrësit rritën njohuritë dhe aftësitë mbi planin e Marketingun Strategjik, njohjen e audiencës si dhe mjetet për të promovuar produktin final. Paralelisht me modulet, nëpërmjet mentorimeve organizatat janë mbështetur për të analizuar gatishmërinë e tyre në ofrimin e produkteve dhe shërbimeve me pagesë, kapacitetin organizativ, si dhe mundësitë që ofron tregu vendas, rajonal e më gjerë për produktet dhe shërbimet potenciale.*





*Gjatë programit të trajnimit – "Gjenerimi i të ardhurave për OSHC-të nga shërbimet me pagesë, produktet dhe asetet"*

### 2 Manaxhimi dhe monitorimi i granteve

*Në muajin korrik u finalizua programi i trajnimit "Manaxhimi dhe monitorimi i granteve". Përgjatë 2 moduleve të fundit, u punua mbi çështje të tilla si parimet e përgjithshme administrative të granteve; rregullat e kontratës së grantit; parimet financiare; raportimi i granteve; procedura e monitorimit dhe; vlerësimit dhe mbyllja e grantit. Programi i trajnimit "Manaxhimi dhe monitorimiie granteve" do të ristartojë sërish vitin e ardhshëm, për t`i ardhur në ndihmë të gjitha organizatave që duan të rrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre praktike në manaxhimin e skemave të nën-grantimit nga donatorë të ndryshëm. Për të gjitha organizatat e interesuara për t'u përfshirë në program, na kontaktoni në info@resourcecentre.al.*



*Gjatë programit të trajnimit – "Manaxhimi dhe monitorimi i granteve"*

### 3 "Vullnetarizmi dhe pjesëmarrja e OSHC-ve në Programet e BE"

*Një program i tretë trajnimi, këtë radhë me OSHC nga Tirana, Elbasani dhe Durrësi u zhvillua në shtator mbi "Vullnetarizmi dhe pjesëmarrja e OSHC-ve në Programet e BE". Përgjatë dy ditë trajnimi, pjesëmarrësit patën mundësi të rrisin njohuritë e tyre mbi programet e BE-së mbi vullnetarizmin dhe procesin e aplikimit për akreditim (Label Quality) për t'u bërë pjesë e këtyre programeve në nivel Evropian.*

*Në përfundim të ciklit të trajnimeve rajonale mbi këtë temë, OSHC -të e interesuara për tu akredituar dhe bërë pjesë e programit European Solidarity Corps do të asistohen nëpërmjet asistencës teknike dhe mentorimit individual me qëllim përfundimin me sukses të procesit të aplikimit.*

# Fuqizim kapacitetesh

## Programe Trajnimi për OSHC-të

### Programe trajnimi mbi "Fiskalizimi i OJF-ve"

*Nisur nga kërkesat dhe interesi për këtë çështje, gjatë muajit korrik Qendra Burimore dhe Partnerët Shqipëri zhvilluan një program trajnimi mbi Fiskalizimin me pjesëmarrjen e 19 përfaqësuesve të organizatave të shoqërisë civile nga mbarë vendi. Në fokus të trajnimit ishte kuadri ligjor dhe procesi i fiskalizimit, duke u ndalur konkretisht në hapat e tij si dhe elementët e nevojshëm për procesin e Fiskalizimit. Për më shumë rreth këtij procesi, gjeni këtu një përmbledhje të pyetjeve më të shpeshta dhe çështjeve kryesore mbi Fiskalizimin.*

*Gjatë programit të trajnimit – "Fiskalizimi i OJF-ve"*

### Crowdfunding dhe të tjera Burime Alternative për Ngritjen e Fondeve

*Përgjatë shtatorit u organizuan nje seri programesh trajnimi mbi "Crowdfunding dhe të tjera Burime Alternative për Ngritjen e Fondeve" me përfaqësues të OShC-ve nga Vlora, Gjirokastra, Berati, Lushnja, Shkodra dhe Tirana. Pjesëmarrësit rritën njohuritë dhe morën informacione praktike mbi disa forma e burime alternative financimi, si një mënyrë për të fuqizuar OSHC-të dhe rritur qendrueshmërinë e tyre financiare.*

*Gjatë trajnimeve u nda edhe thirrja e dytë për projekte në smile.al, platformën e parë Crowdfunding në Shqipëri. Mësoni më shumë rreth platformës këtu*




*Gjatë programit të trajnimit – "Crowdfunding dhe të tjera Burime Alternative për Ngritjen e Fondeve"*

## Forume Rajonale mbi Ndikimin e Covid-19 në Ballkanin Perëndimor

*Nën drejtimin e Partnerëve Shqipëri, pesë organizata nga rajoni që shërbejnë si qendra burimore për shoqërinë civile në vendet e tyre, po zbatojnë një nismë të përbashkët që përmes një serie diskutimesh kontribuon në shkëmbimin e përvojës, praktikave më të mira dhe sfidave të përshtatshmërisë në përgjigje të Covid -19.*









*Në korrik organizuam forumin e gjashtë (dhe të fundit) rajonal të diskutimit mbi "Të drejtat e njeriut dhe aksesin në informacion". Forumi mblodhi përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile, rrjeteve rajonale, organizatave ndërkombëtare, akademisë, institucioneve përkatëse shtetërore dhe aktorëve të tjerë të interesit nga Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut dhe Serbia, të cilët diskutuan mbi rolin e rëndësishëm të mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe aksesit në informacion gjatë kohës së pandemisë, duke theksuar aspektet ligjore të mundësimit të një aktiviteti të tillë, si dhe ndarjen e praktikave më të mira të solidaritetit.*

*Më herët, gjatë këtij viti është publikuar edhe përmbledhja me rastet studimore nga të gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor, e cila ka ushqyer edhe diskutimet në të gjashtë forumet rajonale.* Kliko për më shumë mbi iniciativën

## Barometri Kombëtar i të Drejtave të Njeriut, gjatë periudhës së Pandemisë Covid-19

*Në datën 17 korrik 2022, Komiteti Shqiptar i Helsinkit prezantoi gjetjet kryesore të studimit "Barometri Kombëtar - Ndikimi I Pandemisë Covid-19 në të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut në Vendin Tonë" në një tryezë me përfaqësues nga institucione dhe organizata të shoqërisë civile.*

*Barometri përpunon dhe analizon nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, të dhënat e përfituara nga një sondazh i realizuar me qytetarë dhe studentë, sa i takon perceptimit të tyre për masat anti-covid dhe kufizimet e disa prej të drejtave e lirive themelore të njeriut, përgjatë periudhës së pandemisë. Ndër këto të drejta mund të përmendim të drejtën për informim, lirinë e lëvizjes, të drejtën për tubim, të drejtën për kujdes shëndetësor, të drejtat në sferën ekonomike, si dhe të drejtën për arsim për periudhën Mars 2020-Dhjetor 2021.* Lexo raportin e plotë

## Tirana Connectivity Forum

*Përgjatë datat 26-28 shtator u zhvillua edicioni i 8-të i Tirana Connectivity Forum në Durrës dhe Tiranë, duke bërë bashkë vendimmarrës, politikanë, financierë, organizata të shoqërisë civile, institucione të BE-së dhe grupe interesi nga e gjithë Evropa Juglindore dhe nga Bashkimi Evropian.*

*Mes shumë panelesh, përfaqësuesish të organizatave ndërkombëtare dhe joqeveritare nga rajoni dhe Evropa, u diskutua mbi rolin dhe kontributin e shoqërisë civile për krijimin e institucioneve të shëndetshme dhe politikëbërjen demokratike. Pjesëmarrësit në këtë forum u fokusuan mbi nxitjen e llogaridhënies institucionale; bashkëpunimin me BE-në; ndërtimin e partneriteteve gjithëpërfshirëse për politikëbërje efikase; bashkëpunimin rajonal dhe integrimin evropian – nga zgjerimi në kohezion.*

*TCF 2022 organizohet nga Cooperation and Development Institute,Kongresi Rinor Kombëtar, Konrad-Adenauer-Stiftung Albanien, Hanns-Seidel-Stiftung, Heinrich-Böll-Stiftung, Regional Cooperation Council – RCC, dhe këtë vit vjen edhe në kuadër të Tirana European Youth Capital 2022 dhe European Year of Youth. Për më shumë*

## Të qënit i përgjeshëm- Rrugët tona të ndryshme drejt gjithëpërfshirjes, diversitetit dhe kalimit të pushtetit

*Në vitet e fundit, në përpjekje për të matur se sa të ndryshme dhe gjithëpërfshirëse janë OSHC -të standarde, indekse dhe metodologji të ndryshme janë zhvilluar. Por të vlerësuarit dhe monitoruarit të përgjegjshmërisë dhe gjithëpërfshirjes si dhe përzgjedhja e qasjes së duhur në përshtatje me mjedisin operues shpesh herë paraqitet sfidues për OSHC-të. Për të diskutuar midis kolegëve dhe njohur më tej me qasjet e shumta që OSHC-të po përdorin për të aplikuar diversitetin dhe përfshirjen në punën e tyre, Accountable Now më 30 gusht zhvilloi një webinar me OSHC nga mbarë globi. Prezantimi i metodologjive të ndryshme që mund të përdoren nga OSHC-të për vlerësimin e zbatueshmërisë të diversitetit dhe përfshirjes por mbi të gjitha diskutimi i sfidave të hasuara nga OSHC-të dhe ndarja e eksperiencave të tyre në këtë rrugëtim ishin në focus të aktivitetit. Gjej këtu webinar e plotë*




## Konferenca "Politika Rinore në Ballkanin Perëndimor"

*Konferenca "Politika Rinore në Ballkanin Perëndimor" e fokusuar në politikat rinore në Ballkanin Perëndimor u zhvillua më 16 shtator në Pragë, duke mbledhur së bashku anëtarë të KESE-së, përfaqësues të OSHC-ve nga vendet e Ballkanit Perëndimor, si dhe zyrtarë çekë dhe përfaqësues të OSHC-ve.*

*Me pikën kryesore perspektiva e anëtarësimit dhe roli i të rinjve në proces, konferenca siguroi hapësirë për ekspertët dhe vendimmarrësit me prejardhje të ndryshme për të përcaktuar dhe për t'i dhënë përparësi sjelljes së çështjeve, duke u zotuar për të bashkuar përpjekjet drejt zgjidhjeve efikase.*

*Thirrja për BE-në për të vazhduar mbështetjen për të rinjtë e Ballkanit Perëndimor arriti në përfundimin zyrtar të eventit si përforcimin e programeve të BE-së dhe strukturave rajonale, për të arritur më shumë të rinj në Ballkanin Perëndimor duke u ofruar atyre mundësi për arsim, lëvizshmëri, vullnetarizmi dhe punësimi. Dokumenti që përmban gjithsej 29 përfundime që dalin nga temat e diskutuara gjatë konferencës është vënë në dispozicion të publikut. Për më shumë mbi rekomandimet lexoni këtu*









THIRRJE DHE MUNDËSI

## *KALENDAR TREMUJOR*

*Shënoni në kalendarin tuaj! Përfshihu në aktivitetet tona të ardhshme!*

**Tetor 2022**

| S | M | T | W | T | F | S |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | 1 | 2 |
| 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 |
| 10 | 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 |
| 17 | 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 |
| 24 | 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 |
| | | | | | | |

**Nëntor 2022**

| S | M | T | W | T | F | S |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| 13 | 14 | 15 | 16 | 17 | 18 | 19 |
| 20 | 21 | 22 | 23 | 24 | 25 | 26 |
| 27 | 28 | 29 | 30 | | | |
| | | | | | | |

**Dhjetor 2022**

| S | M | T | W | T | F | S |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | 1 | 2 | 3 |
| 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 |
| 11 | 12 | 13 | 14 | 15 | 16 | 17 |
| 18 | 19 | 20 | 21 | 22 | 23 | 24 |
| 25 | 26 | 27 | 28 | 29 | 30 | 31 |
| | | | | | | |

*Akademia e OJF-ve* *Trajnime dhe Seminare për OShC-të* *Aktivitete rrjetëzimi* *Forume Publike dhe Evente*

*NA KONTAKTONI :*


*Zyra në Tiranë*

*Rruga e Elbasanit, PARK GATE, Kati i 10të, Ap. 73, Tiranë*

*(në mjediset e "Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim")*
*Tel/Fax: +355 4 2254881*

*E-mail: info@resourcecentre.al*

*Zyra në Shkodër*

*Lagjja Kongresi i Përmetit, Rr. Oso Kuka, Kati i 2të, Hyrja 1, Shkoder*
*(në mjediset e Shoqatës "Gruaja në Zhvillim")*

*E-mail: shkodra@resourcecenter.al*

*Zyra në Vlorë*

*Lagjja 29 Nëntori, Rr. Dede Ahmet Amataj, Çerdhja 15, Kati i 2të, Vlorë*

*(në mjediset e Qendrës "Aulona")*
*Tel: +355 3 3224531*

*E-mail: vlora@resourcecenter.al*


*NA NDIQNI :* resourcecentre.al resourcecentrealbania resourceCSO_al ResourceCentreAlbania

http://www.resourcecentre.al/ National Resource Centre for Civil Society in Albania